

[\[Printo\]](#)

[\[Google Translate\]](#)

VENDIM

Nr. 44, datë 29.1.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 719, DATË 20.10.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 66 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 "Për peshkimin", të neneve 6 e 7 të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5 e vendimit nr. 719, datë 20.10.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

"5. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës ka për mision përmbushjen e të gjitha shërbimeve të nevojshme shtetërore që lidhen me menaxhimin e infrastrukturës dhe të dhënave të peshkimit e të akuakulturës, si dhe garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në mbrojtjen e peshkimit dhe akuakulturës në Republikën e Shqipërisë.

Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës kryen këto detyra:

- a) menaxhon infrastrukturën e peshkimit, përfshirë portet dhe qendrat e peshkimit;
- b) grumbullon të dhënat e peshkimit;
- c) harton programet e ripopullimit të kategorive ujore;
- ç) menaxhon qendrën dhe impiantet e midhjes në Sarandë;
- d) menaxhon ekonomitë e rasateve të peshkut në Zvezdë, Korçë, të rasateve të koranit në Lin, Pogradec, dhe ekonomitë e tjera të rasateve të peshkut;
- dh) garanton respektimin e kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së peshkimit dhe akuakulturës nëpërmjet monitorimit dhe inspektimit të veprimtarisë së peshkimit. Monitorimi dhe inspektimi i veprimtarisë së peshkimit kryhen nga sektori i monitorimit dhe i kontrollit të peshkimit, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Copyright 2013 - www.ligjet.org